



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1601, datë 30.05.2011**

**Për**

**Ankimimin administrativ të Eagle Mobile sh.a., ndaj Vendimit nr. 1560 datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 30.05.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Ankimimi administrativ i Eagle Mobile sh.a., ndaj Vendimit nr. 1560 datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a.”**

**BAZA LIGJORE:**

- Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);

- Neni 137, e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
- Rregullore nr. 13, datë 16.04.2010, “Për portabilitetin e numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1219, datë 07.04.2010.
- Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të ligjit nr. 9918,
- Vendimi nr. 1467, datë 23.12.2010, i Këshillit Drejtues për “Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a”

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit “Eagle Mobile sh.a.” me nr. 1869 Prot., datë 10.05.2011, të depozituar në AKEP, me anë të së cilës ka paraqitur ankimin administrativ me objekt: Ndryshimin e Vendimit nr. 1560 datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a.”;
- Vendimit nr. 1560 datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a.”;
- Projektvendimin mbi ankimimin administrativ të Eagle Mobile sh.a., ndaj Vendimit nr. 1560 datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a.”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

1. Ankimi administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi Sipërmarrësi Eagle Mobile sha.a. me shkresën nr. 1869 Prot., datë 10.05.2011, është në përputhje me:  
Pikën 1, të nenit 140, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
2. Eagle Mobile sh.a. (Eagle), me anë të këtij ankimi administrativ kërkon:
  - 2.1 Në pikën 1/a, të Vendimit nr. 1560, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën “n” shtuar në seksionin I “Përmbledhje”, të ORI të Eagle, të shtohen edhe paragrafët:

- a) Për zbatimin e këtyre detyrimeve, AKEP do të udhëzojë, kontrollojë dhe testojë të gjithë operatorët të cilët duhet të rrugëzojnë thirrjet drejt rrjetit të duhur për numrat e portuar.
- b) Eagle ka detyrimin të lidhë marrëdhënie të drejtpërdrejtë Interkoneksioni (lidhje fizike) vetëm me operatorët të cilët plotësojnë kushtin e mësipërm dhe janë të “çertifikuar” nga AKEP për këtë proces.

2.2 Ndryshimi i sipërpërmendur të reflektohet edhe në Ankesin II, të ORI të Eagle Mobile sh.a.

3. Eagle, në lidhje me ndryshimet e kërkuara, argumenton se:

- Eagle, ka detyrimin të lidhë marrëveshje interkoneksioni vetëm me operatorët që dëshmojnë realisht se plotësojnë kushtet e portabilitetit të numrit, analizën dhe rrugëzimin sipas ACQ;
- Në se një operator Rural, nuk mund të analizojë dhe rrugëzojë thirrjet drejt numrave të portuar në një rrjet tjetër, atëherë rrjedhimisht, thirrjet e dërguara në destinacionin e gabuar do të dështojnë, si pasojë operatorët celularë në treg do të kenë humbje të konsiderueshme që vijnë nga dështimi i thirrjeve për shkakun e lartpërmendur.
- Sa me sipër, Eagle Mobile sh.a., do të pësojë humbje në cilësinë e shërbimit, humbje financiare të konsiderueshme nga trafiku hyrës i parealizuar si dhe ankesa nga pajtimtarët e tij.

4. Këshilli Drejtues, sa i përket pretendimeve të ngritura në ankimimin administrativ të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a., arsyeton si më poshtë:

4.1 a) Në lidhje me pretendimin sipas pikës 2.1/a, të lartpërmendur të Eagle, sqarojmë se,

- Oferta Referencë e Interkoneksionit (*në të cilën Eagle kërkon të bëhet ky ndryshim*), përcakton kriteret dhe procedurat për rregullimin e marrëdhënieve të interkoneksionit ndërmjet një sipërmarrësi (*Eagle Mobile*) dhe Operatorit Përfitues, në lidhje me fasilitetet shoqëruese të interkoneksionit.
- Roli dhe detyrimet e AKEP, janë të përcaktuara në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret e nxjerra në bazë e për zbatim të tij. Për rastin konkret, i referohemi Rregullores nr. 13, datë 16.04.2010, “Për portabilitetin e numrit”, miratuar nga Këshilli Drejtues me Vendimin nr. 1219, datë 07.04.2010.

b) Në lidhje me pretendimin sipas pikës 2.1/b, të lartpërmendur të Eagle, sqarojmë se, bazuar në nenin 7, të Rregullores nr. 13, datë 16.04.2010, të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike, të disponueshme për publikun, duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve në numra të bartur gjeografikë dhe të lëvizshëm. Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “all call query-kërkimi për çdo thirrje”.

Sa më sipër, të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike, të disponueshme për publikun, janë të detyruar të marrin masat për të përmbushur kërkesat e parashikuara në këtë rregullore.

5. Në përfundim, arrijmë në konkluzionin se ankimi administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a., për ndryshimin e Vendimit nr. 1560, datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a.”, gjendet i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 137 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

### **V E N D O S:**

1. Lënien në fuqi të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 1560, datë 20.04.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a.” dhe rrëzimin e ankimimit të Eagle Mobile sh.a.
2. Të njoftohet Eagle Mobile sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**KRYETARI**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURÇE**